

PROJEKT MARREVESHJE

PER : BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“Imperial Group” sh.a dhe “Imperial C. Construction” sh.p.k

Tirane, me 02 Maj 2023

Shoqeria “Imperial Group” sh.a eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 24/12/2010, me seli *Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2,Tirane.*

Shoqeria “Imperial Group” sh.a me NIPT-in L02424005D, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 1,422,427,659 leke me kontribut 22 % te Ortakut Kolë Gjoka, 56 % Te Ortakut Pellumb Gjoka dhe 22 % te Ortakut Alida Gjoka. Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 15/07/2016, me seli *Rruga "Jeronim De Rada", Nr 43, Nr pasurie 6/348+1-43, Zona Kadastrale 8150,Tirane.*

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k me NIPT-in L61915015H, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 100.000 leke me kontribut 100% te Ortakut te Vetem L61915015H. Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimarrese te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te nenit 215 pika 1.

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” hartohet ky projek per bashkimi e shoqerive me keto kushte :

1.Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “Imperial Group” sh.a do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “Imperial C. Construction.” sh.p.k do te jete shoqeria e perthithur.

2.Raporti kembimit te Kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shumta e kapitalit themeltar te seciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit themeltar te shoqerise se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe secili ortak ne raport me pjesemarrjen ne kapitalit themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e secilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

3.Kushtet e ndarjes se kuotave te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do jete mbi bazen e raportit qe ze secili kapital themeltar i shoqerive te veçanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.

J

4. **Data**, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqërisë se re pas perthithjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit do të jete 01.04.2023.
5. **Data**, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë “Imperial C. Construction.” sh.p.k që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a do të jete 01.04.2023.
6. **Të drejtat** që shoqëria përthithëse “Imperial Group” sh.a u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), janë ato që percaktohen në statutin e shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a dhe në zbatim të ligjit 9901 date 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqërite Tregetare”.
7. **Perparesite** apo kufizimet e Administratorit të shoqërisë se re pas perthithjes do të jene ato që i njeh statuti i shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a dhe në zbatim të ligjit 9901 date 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqërite Tregetare”.
8. **Pasojat** e bashkimit nuk do të kene asnje influence ndaj të punësuarve të të dyja shoqërive që marrin pjesë në procesin e perthithjes.
9. **Pasojat** e bashkimit nuk do të kene asnje influence ndaj të tretteve të sejciles shoqëri para perthithjes.
10. **Ortakët e shoqërisë** do të jene: 22 % të kapitalit Kolë Gjoka, 56 % të kapitalit Pellumb Gjoka dhe 22 % të kapitalit Alida Gjoka
11. **Emri i shoqërisë** se krijuar nga bashkimi do të jete “Imperial Group” sh.a
12. **Selia e shoqërisë** se re do jete: *Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2*
13. **Statuti i shoqërisë** se re pas perthithjes do të jete ai i shoqërisë “Imperial Group” sh.a para perthithjes
14. **Objekti veprimtarisë i shoqërisë** se re pas perthithjes do të jete ai i shoqërisë “Imperial Group” sh.a para perthithjes
15. **Administratore e shoqërisë** se krijuar nga bashkimi do jete Gentjan Haka me një mandat 5 vjeçar.
16. **Baza e nisjes** për bashkimin do të jene treguesit e bilancit të dates 31.03.2023, ndërsa aktiviteti i vitit 2023 do të jete i perbashket me sistemit e nevojeshme sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në zbatim të ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
17. **Kapitali aksioner dhe Perqindjet** (të trajtuara në pikën 2 dhe 3 si më sipër) e secilit ortak në kapitalin e ri themeltar të krijuar nga bashkimi do të percaktohen pas paraqitjes së aktit të ekspertimit nga shoqëria Audituese "Erleva Gani P.f.
18. **Të drejtat dhe detyrimet** e shoqërisë “Imperial C. Construction.” sh.p.k do t'i kalojnë shoqërisë “Imperial Group” sh.a

Per Shoqërine “Imperial Group” sh.a

Per Shoqërine “Imperial C. Construction” sh.p.k

Perfaqesuesi Ligjor

Gentjan Haka



Perfaqesuesi Ligjor

Gentjan Haka

